

SEKTORI PRIVAT DHE COVID-19

Përmbledhje udhëzimesh për sektorin privat në mbështetje të punonjësve dhe familjeve të tyre gjatë COVID-19



**Më shumë
Zgjedhje** përmes
Politikave Miqësore për Familjen



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation

**Më shumë
Zgjedhje** përmes

Politikave Miqësore për Familjen

SEKTORI PRIVAT DHE COVID-19

Përmbledhje udhëzimesh për sektorin
privat në mbështetje të punonjësve dhe
familjeve të tyre gjatë COVID-19



With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

PËRMBAJTJA

PËRGATITJA E VENDIT TUAJ TË PUNËS PËR COVID-19	3
SEKTORI PRIVAT DHE COVID-19	7
7 MËNYRA SE SI PUNËDHËNËSIT MUND TË MBËSHTESIN PRINDËRIT QË PUNOJNË GJATË PËRHAPJES SË SËMUNDJES SË KORONAVIRUSIT (COVID-19)	10
POLITIKAT MIQËSORE PËR FAMILJEN DHE PRAKTIKAT E TJERA TË MIRA TË VENDEVE TË PUNËS NË KONTEKST TË COVID-19	12
THIRRJE PËR VEPRIM NGA SEKTORI PRIVAT	22



27 shkurt 2020

PËRGATITJA E VENDIT TUAJ TË PUNËS PËR COVID-19

Në janar të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) deklaroi shpërthimin e një sëmundjeje nga koronavirusi i ri në Provincën Hubei, Kinë, si Emergjencë e Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare. OBSH-ja deklaroi se ekziston rrezik i lartë i përhapjes së sëmundjes së koronavirusit 2019 (COVID-19) në vendet e tjera të botës.

OBSH-ja dhe autoritetet e shëndetit publik në gjithë botën po ndërmarrin veprime për të kufizuar përhapjen e COVID-19. Sidoqoftë, suksesi afatgjatë nuk mund të merret si i mirëqenë. Të gjitha pjesët e shoqërisë sonë - përfshirë bizneset dhe punëdhënësit - duhet të luajnë rolin e tyre nëse duam të ndalim përhapjen e kësaj sëmundjeje.

Si përhapet COVID-19

Kur dikush që është i infektuar me COVID-19 kollitet ose lëshon frymën, liron spërklave të lëngjeve trupore të infektuara. Pjesa më e madhe e këtyre spërklave bien në sipërfaqe dhe objekte të afërta - si tavolina, tryeza apo telefona. Njerëzit mund të infektohen me COVID-19 duke prekur sipërfaqet apo objektet e kontaminuara - e më pas duke prekur sytë, hundën ose gojën. Nëse qëndrojnë më pak se një metër larg një personi me COVID-19, ata mund të infektohen me inhalimin e spërklave që lirohen me kollë apo frymëmarrje të infektuarve. Me fjalë të tjera, COVID-19 përhapet ngjashëm me gripin. Shumica e personave të infektuar me COVID-19 kalojnë simptoma të buta dhe shërohen. Megjithatë, disa të tjerë sëmuren më rëndë dhe mund të kenë nevojë për hospitalizim. Rrezikshmëria e sëmundjes serioze rritet me moshën: njerëzit mbi 40 vjeç duket të jenë më të ndjeshëm se ata nën 40 vjeç. Njerëzit me sistem të dobësuar imuniteti dhe njerëzit me sëmundje të tilla ajo e diabetit, zemrës apo mushkërive janë gjithashtu më të ndjeshëm ndaj sëmundjes serioze.

Mënyra të thjeshta për të parandaluar përhapjen e COVID-19 në vendin tuaj të punës

Masat me kosto të ulët të përmendura më poshtë do të ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së infeksioneve në vendin tuaj të punës, si ftohjet, gripin dhe gastroenteritin, si dhe në mbrojtjen e klientëve, kontraktuesve dhe punonjësve tuaj.

Punëdhënësit duhet të fillojnë t'i bëjnë këto gjëra qysh tash, edhe nëse COVID-19 nuk ka arritur në komunitetet ku vepronë. Punëdhënësit mund të ulin numrin e ditëve të punës të humbura për shkak të sëmundjes dhe të ndalin apo ngadalësojnë përhapjen e COVID-19, nëse arrin në ndonjë nga vendet tuaja të punës.

- Sigurohuni që vendet e punës të jenë të pastra dhe higjienike
 - Sipërfaqet (p.sh., tryezat dhe tavolinat) dhe objektet (p.sh. telefonat, tastierat) duhet të fshihen rregullisht me dezinfektues
 - Pse? Sepse kontaminimi mbi sipërfaqet e prekura nga punonjësit dhe klientët është një nga mënyrat kryesore për përhapjen e COVID-19
- Promovoni pastrimin e rregullt e të thuktë të duarve nga ana e punonjësve, kontraktuesve dhe klientëve
 - Vendosni bombolat e dezinfektuesve për duar në vende të dukshme përreth vendit të punës. Sigurohuni që këto bombola të mbushen rregullisht

- Vendosni postera që promovojnë larjen e duarve - kërkonte këto nga autoritetet lokale të shëndetit publik ose shihni tek www.WHO.int.
- Kombinojeni këtë me masa të tjera të komunikimit, siç janë ofrimi i udhëzimeve nga zyrtarët e shëndetit dhe sigurisë në punë, njoftime në takime dhe informata në faqe interneti, për të promovuar larjen e duarve
- Sigurohuni që stafi, kontraktuesit dhe klientët të kenë qasje në hapësira ku mund të lajnë duart me sapun dhe ujë
- Pse? Sepse larja e duarve vret virusin në duart tuaja dhe parandalon përhapjen e COVID-19
- Promovoni higjienë të mirë respiratorike në vendin e punës
 - Vendosni posterë që promovojnë higjienën respiratorike. Kombinojeni këtë me masa të tjera të komunikimit, siç janë ofrimi i udhëzimeve nga zyrtarët e shëndetit dhe sigurisë në punë, njoftime në takime dhe informata në faqe interneti, etj.
 - Sigurohuni që maskat për fytyrë dhe/ose faculetat e letrës të jenë të disponueshme në vendet e punës, për ata që kanë rrjedhje të hundëve apo kolliten në punë, së bashku me koshat me kapakë për largimin higjienik të tyre
 - Pse? Për shkak se higjiena e mirë respiratorike parandalon përhapjen e COVID-19
- Këshilloni punonjësit dhe kontraktuesit që të konsultohen me këshillat shtetërore para se të organizojnë udhëtime zyrtare.
- Njoftoni punonjësit, kontraktuesit dhe klientët tuaj që nëse COVID-19 fillon të përhapet në komunitetin tuaj, secili që ka qoftë edhe kollë të butë ose temperaturë mbi 37.3 C duhet të qëndrojë në shtëpi. Ata gjithashtu duhet të qëndrojnë në shtëpi (ose të punojnë nga shtëpia) nëse duhet të marrin ilaçe të thjeshta, siç janë paracetamoli/acetaminofeni, ibuprofeni ose aspirina, të cilat mund të maskojnë simptomat e infeksionit.
- Vazhdoni të komunikoni dhe promovoni mesazhin se njerëzit duhet të qëndrojnë në shtëpi edhe nëse kanë vetëm simptoma të buta të COVID-19.
- Vendosni posterë me këtë mesazh në vendet tuaja të punës. Kombinojeni këtë me kanale të tjera të komunikimit që përdoren zakonisht në organizatën apo biznesin tuaj.
- Shërbimet tuaja të shëndetit profesional, autoritetet lokale të shëndetit publik ose partnerët tjerë mund të kenë zhvilluar materiale fushate për të promovuar këtë mesazh
- Bëjeni të qartë për punonjësit se ata mund ta regjistrojnë këtë kohë të humbur si ditë të pushimit mjekësor.

Gjëra që duhen marrë parasysh kur ju dhe punonjësit tuaj udhëtoni

- Para udhëtimit
- Sigurohuni që organizata juaj dhe punonjësit e saj të kenë informatat më të reja mbi hapësirat ku po përhapet COVID-19. Këtë mund ta gjeni tek <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/situation-reports/>
- Në bazë të informatave më të fundit, organizata juaj duhet të vlerësojë dobritë dhe rreziqet lidhur me planet e udhëtimeve të ardhshme.
- Shmangni dërgimin e punonjësve të cilët mund të kenë rrezik më të madh të sëmundjeve të rënda (p.sh., punonjësit e moshuar dhe ata me gjendje shëndetësore si diabeti, sëmundje të zemrës apo mushkërive) në zonat me përhapje të COVID-19.

¹ Më mirë maska të zakonshme kirurgjike sesa maska për fytyrën N95

- Sigurohuni që të gjithë personat që udhëtojnë në zona që raportohen të kenë COVID-19 të informohen nga një profesionist i kualifikuar (p.sh. shërbimet e shëndetit profesional, institucione shëndetësore ose partneri lokal i shëndetit publik)
- Të merret parasysh edhe dhënia e shisheve të vogla (nën 100 CL) me dezinfektues me bazë alkooli punonjësve që duhet të udhëtojnë. Kjo mund të mundësojë larje të rregullt të duarve.

Gjatë udhëtimit:

- Inkurajoni punonjësit të lajnë duart rregullisht dhe të qëndrojnë së paku një metër larg nga njerëzit që kolliten ose teshtijnë
- Sigurohuni që punonjësit e dinë se çfarë të bëjnë dhe me kë të kontaktojnë nëse ndjehen të sëmurë gjatë udhëtimit.
- Sigurohuni që punonjësit tuaj të respektojnë udhëzimet e autoriteteve të vendit drejt të cilit udhëtojnë. Nëse, për shembull, atyre u thuhet nga autoritetet lokale të mos shkojnë diku, ata duhet ta respektojnë këtë udhëzim. Punonjësit tuaj duhet të respektojnë çdo kufizim lokal të udhëtimit, lëvizjes apo tubimeve të mëdha.

Kur ju ose punonjësit tuaj ktheheni nga udhëtimi:

- Punonjësit që janë kthyer zona me përhapje të COVID-19 duhet të monitorojnë veten për simptoma për 14 ditë dhe të matin temperaturën e tyre dy herë në ditë.
- Nëse zhvillojnë kollë të butë ose temperaturë sado të ngritur (p.sh. temperaturë prej 37.3 C apo më shumë), ata duhet të qëndrojnë në shtëpi dhe të izoloohen. Kjo do të thotë të shmangin kontaktin e afërt (një metër ose më afër) me njerëzit e tjerë, përfshirë anëtarët e familjes. Ata gjithashtu duhet të telefonojnë institucionin e tyre shëndetësor ose departamentin lokal të shëndetit publik, duke u dhënë detaje për udhëtimin dhe simptomat e tyre të fundit.

Përgatitja e biznesit tuaj në rast se COVID-19 arrin në komunitetin tuaj

- Hartoni një plan se çfarë do të bëni nëse dikush sëmuret apo dyshohet me COVID-19 në ndonjë nga vendet tuaja të punës
 - Plani duhet të përfshijë edhe vendosjen e personit të sëmurë në ndonjë dhomë ose hapësirë ku janë të izoluar nga të tjerët në vendin e punës, duke kufizuar numrin e personave që kanë kontakt me personin e sëmurë dhe duke kontaktuar autoritetet lokale shëndetësore.
 - Mendojeni se si do t'i identifikoni personat që mund të jenë të rrezikuar, dhe t'i mbështesni, pa shkaktuar stigmatizim apo diskriminim në vendin e punës. Kjo mund të përfshijë personat që kanë udhëtuar së voni në zona ku raportohen raste, apo personel tjetër që kanë gjendje që i vë ata në rrezik më të madh të sëmundjes serioze (p.sh. diabeti, sëmundje të zemrës dhe mushkërive, moshë më e vjetër).
 - Tregoni autoritetit lokal të shëndetit publik që jeni duke zhvilluar planin dhe kërkonti kontributin e tyre.
- Promovoni rregullisht punën nga distanca në organizatën tuaj. Nëse ka një shpërthim të COVID-19 në komunitetin tuaj, autoritetet shëndetësore mund t'i këshillojnë njerëzit të shmangin transportin publik dhe vendet e mbushura me njerëz. Puna në distancë do të ndihmojë biznesin tuaj të vazhdojë punën, ndërkohë që punonjësit tuaj qëndrojnë të sigurt.
- Zhvilloni një plan kontigjence dhe të vazhdimësisë së biznesit për një përhapje të mundshme në komunitetet ku biznesi juaj operon
 - Plani do të ndihmojë në përgatitjen e organizatës suaj për mundësinë e një shpërthimi të COVID-19 në vendet e saj të punës ose në komunitet. Ky mund të vlejë edhe për emergjencat tjera shëndetësore

- Plani duhet të trajtojë se si të ruhet veprimtaria e biznesit tuaj edhe nëse një numër i konsiderueshëm i punonjësve, kontraktuesve dhe furnizuesve nuk mund të vijnë tek vendi i punës suaj - qoftë për shkak të kufizimeve lokale të udhëtimit ose sepse janë të sëmurë.
- Komunikoni me punonjësit dhe kontraktuesit tuaj rreth planit dhe sigurohuni që të jenë të vetëdijshëm për atë që duhet të bëjnë - ose të mos e bëjnë - sipas planit. Theksoni pikat kryesore siç është rëndësia e qëndrimit larg nga puna, edhe nëse kanë vetëm simptoma të buta ose u është dashur të marrin ilaçe të thjeshta (p.sh. paracetamol, ibuprofen) të cilat mund të maskojnë simptomat
- Sigurohuni që plani juaj të adresojë pasojat në shëndetin mendor, fizik e social të një rasti COVID-19 në vendin e punës ose në komunitet, dhe të ofrojë informata e mbështetje.
- Për bizneset e vogla dhe të mesme, pa kapacitete të brendshme të shëndetit dhe mirëqenies së stafit, zhvilloni partneritete dhe plane me institucionet vendore shëndetësore dhe sociale, para çfarëdo emergjence të mundshme.
- Autoriteti juaj shëndetësor lokal ose kombëtar i shëndetit publik mund të ofrojë mbështetje dhe udhëzime për zhvillimin e planit tuaj.

Mbani mend:

Koha për t'u përgatitur për COVID-19 është tash. Masat paraprake dhe planifikimi i thjeshtë mund të bëjnë një ndryshim të madh. Veprimi i menjëhershëm do të ndihmojë në mbrojtjen e punonjësve tuaj dhe biznesit tuaj.

Si të qëndroni të informuar:

Gjeni informacionin më të fundit nga OBSH-ja se ku po përhapet COVID-19: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/situation-reports/>

Këshilla dhe udhëzime nga OBSH për COVID-19 <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019>

<https://www.epi-win.com/>



SEKTORI PRIVAT DHE COVID-19

Roli i sektorit privat në reagimin ndaj pandemisë

Ky shënim i shkurtër shpjegon se si, në kohën e pandemisë së koronavirusit (COVID-19), sektori privat mund të vazhdojë bizneset e veta dhe të kontribuojë në lehtësimin e qasjes në mallëra e shërbime të grupeve më të cenueshme në shoqëri. kështu, shpjegimi mëton të ofrojë udhëzime për njerëzit dhe kompanitë e sektorit privat.

Për shkak të shpërthimit të COVID-19, kompanitë duhet të bëjnë ndryshime rrënjësore në qasjet e tyre ndaj proceseve afariste - mu si çdo palë tjetër në kohë pandemie.

Do të jetë gjithnjë e më e vështirë të sigurohet vazhdimësia e biznesit pa marrë masa kundër pandemisë COVID-19, nëse punohet si zakonisht. në kohëra të tilla, kompanitë duhet të marrin masa mbrojtëse për të vazhduar bizneset e tyre duke marrë parasysh kushtet dhe nevojat e ndryshme të punonjësve të tyre, derisa fokusohen edhe tek mirëqenia e punonjësve edhe tek rimëkëmbja.

Çfarë mund të bëjnë kompanitë e sektorit privat për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen e punonjësve të tyre gjatë kësaj periudhe?

- Të zbatojnë politikën e të punuarit nga shtëpia për të gjithë punonjësit.
- Nëse punonjësve tuaj u kërkohet të vijnë në punë, kushtojini vëmendje higjienës në vendet e punës në përputhje me këshillat e [Organizatës Botërore të Shëndetësisë](#) (OBSH) dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Sigurohuni që punonjësit tuaj të kenë hapësirë të mjaftueshme ndërmjet njëri-tjetrit (të paktën 1.5 metra hapësirë nga njëri-tjetri). Mos autorizoni udhëtime zyrtare për punonjësit tuaj, përveç nëse është absolutisht urgjente dhe e domosdoshme.
- Organizoni seminare virtuale për punonjësit në tema si shëndeti dhe higjiena në kohë të pandemisë COVID-19, ndikimet e dhunës ndaj grave, ballafaqimi me mekanizmat e dhunës dhe mekanizmat e tjerë lidhur me dhunën me bazë gjinore.
- Sigurohuni që punonjësit tuaj të kenë baraspeshë të shëndoshë mes punës dhe jetës gjatë kësaj periudhe. Barra e punëve dhe kujdesit në shtëpi është ndryshe për burrat dhe ndryshe për gratë. Gratë kryejnë punë të tilla tri herë më shumë se burrat. Prandaj, vlerësoni nevojat e grave punëtore në kushtet e reja të punës dhe zbatoni masa të posaçme për adresimin e nevojave të tilla. Përveç kësaj, avokoni në mënyrë aktive për ndarje të barabartë të punëve dhe kujdesit në shtëpi mes burrave e grave.
- Informoni gratë shtatzëna dhe ato gjidhënëse, si dhe gratë me fëmijë të vegjël për masat e posaçme që mund të duhet të ndërmarrin në kohën e pandemisë. Ju mund të përdorni [manualin](#) e UNFPA-së për më shumë informata. Theksoni mesazhin që kujdesi për fëmijët është përgjegjësi e barabartë si për nënën ashtu edhe për babanë.
- Ndërmerrni masa të posaçme për gratë punëtore që i ekspozohen dhunës me bazë gjinore (DhBGj) ose janë të kërcënuara nga DhBGj. Sipas [shënimit të fundit informativ](#) të publikuar nga Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara (UNFPA), izolimi afekton burrat dhe gratë ndryshe, pasi që në disa vende të Kosovës ka pasur 100 për qind rritje të DhBGj-së ku

kryesisht viktime kanë qenë gratë. Dhuna në familje rritet në mënyrë drastike në vendet ku Covid-19 përhapet. Informoni gratë punonjëse për [linjat telefonike për dhunën në familje](#). Përkujtoni punonjësit tuaj për politikën e kompanisë suaj për “Luftimin e dhunës në familje” ose “Promovimin e barazisë gjinore”, dhe kujtojeni atyre që mund të gëzojnë përkrahje sipas kësaj politike në rast të ndonjë incidenti të dhunës në familje.

- Sigurimi i planifikimit familjar dhe produkteve tjera të shëndetit seksual e riprodhues, përfshirë produktet menstruale, janë qenësore për shëndetin e grave, fuqizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të cilat mund të ndikohen kur zinxhirët e furnizimeve të vihen nën trysni nga reagimi pandemik. Sigurohuni që punonjësit tuaj të pajisen me produkte për planifikimin e familjes, shëndetin seksual dhe riprodhues. Ju lutemi shikoni [shënimin informativ të UNFPA-së](#) për më shumë informata.
- Për të siguruar që askush të mos mbetet prapa, merrni masa të posaçme për punonjësit që janë në grupmohën më të prekur nga kjo pandemi ose ata me sëmundje kronike ose gjendje para-ekzistuese. Përveç këtyre, sigurohuni që punonjësit me aftësi të kufizuara të gëzojnë mbështetjen e duhur për plotësimin e nevojave të tyre specifike. Lehtësoni qasjen e këtyre grupeve në shërbimet shëndetësore dhe ofrojuni mundësi, në mënyrë që të mund t'i plotësojnë nevojat e tyre të përditshme më lehtë. Kushtet e reja të punës nuk duhet që t'i vënë ata në pozitë edhe më të pafavorshme.

Si mund të bëjmë ndryshimin për komunitetin gjatë kësaj periudhe?

- Ju mund të ofroni kontribute të drejtpërdrejta për ofruesit e shërbimeve, institucionet publike dhe organizatat ndërkombëtare dhe humanitare, të cilat janë në vijë të parë të përpjekjeve për ndihmë ndaj koronavirusit.
- Ju mund të ofroni mundësi të veçanta në fushën tuaj të biznesit për profesionistët shëndetësorë që kanë ngarkesë pune shumë të rëndë. Për shembull:
 - Nëse jeni pjesë e industrisë hoteliere, mund t'i vini dhomat tuaja në dispozicion të profesionistëve shëndetësorë që nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre pas punës.
 - Nëse jeni kompani e tekstilit, mund të prodhoni pajisje personale mbrojtëse për profesionistët shëndetësorë, pas marrjes së lejeve të nevojshme nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe duke krijuar mekanizma të sigurimit të cilësisë.
 - Nëse jeni kompani logjistike, mund të ofroni mbështetje për plotësimin e nevojave të institucioneve të ndryshme.
- Ju mund të kryeni aktivitete që shënjestrojnë grupe të pafavorizuara (të moshuar, persona me sëmundje kronike ose aftësi të kufizuara) dhe mund të filloni nisma për t'u ndihmuar që të përdorin mjete digjitale në mënyrë efektive gjatë distancës sociale dhe qëndrimit në shtëpi.
- Ju mund të kontribuoni në aktivitete që ndihmojnë integrimin e të rinjve në jetën shoqërore përmes mjedisit digjital, jeta arsimore dhe e përditshme e të cilëve është shkëputur, dhe izolimi i të cilëve është qenësor, pasi që ata mund të infektojnë pa dashje njerëzit e tjerë me virus. Ju lutemi shihni [shënimin e UNFPA](#) për këtë temë.
- Ju mund të kontribuoni në masa mbrojtëse dhe aktivitete informuese që u drejtohen grave shtatzëna, atyre që kanë lindur rishtazi, apo gratë gjdhënëse.
- Ju mund të kontribuoni në studimet shkencore për sëmundjen Covid-19.

- Ju mund të përdorni mediet tradicionale dhe ato të reja për të ofruar informata dhe për të ngritur vetëdijesimin për çështjet e mëposhtme:

Për masat mbrojtëse kundër shpërthimit të Covid-19;

- *Mbi linjat ekzistuese telefonike mbi DhBGj-në për gratë që kanë qenë të mbyllura në shtëpitë e tyre, e për këtë arsye mund të jenë ekspozuar më shumë ndaj dhunës, si dhe mbi rritjen e vetëdijes kundër dhunës në familje;*
- *Mesazhe solidariteti dhe bashkëpunimi, si dhe sugjerime dhe aktivitete për të mbrojtur shëndetin mendor të komunitetit në kohën e kësaj pandemie;*
- Ju mund të organizoni fushata vetëdijesimi për Covid-19, dhunën me bazë gjinore dhe nevojat e veçanta të grupeve të pafavorizuara gjatë kohës së pandemisë, etj., në bashkëpunim me personalitetet e famshme me të cilët punoni për promovimin e mallrave dhe shërbimeve të kompanisë suaj.

Për të ndjekur zhvillimet aktuale në lidhje me Covid-19 në botën e biznesit, mund të vizitoni [faqen në internet](#) të Forumit Ekonomik Botëror dhe të shikoni [udhëzimet](#) e Odës Ekonomike Ndërkombëtare.

Sigurohuni që kontributet dhe mbështetja juaj të jenë dizajnuar dhe përdorur në përputhje me parimet humanitare si paanshmëria, neutraliteti, pavarësia dhe humaniteti.



Më poshtë janë dhënë burime të tjera për këtë temë:

1. Organizata Ndërkombëtare e Punës, [COVID-19 and the world of work \(COVID 19 dhe Bota e punës: Global impact and policy responses \(Ndikimi global dhe politikat e reagimit\)\)](#)
2. Organizata Ndërkombëtare e Punës, [New guidelines to help employers support families during COVID-19 \(Udhëzime të reja për të ndihmuar punëdhënësit që të përkrahin familjet gjatë COVID-19\)](#)
3. Ministria e Familjes, Punës dhe Shërbimeve Sociale, [Masat që duhen marrë në vendet e punës kundër shpërthimit të koronavirusit të ri \(COVID-19\)](#)
4. Departamenti Amerikan i Punës, [Guidance on Preparing Workplaces for COVID-19 \(Udhëzues për përgatitjen e vendeve të punës për COVID-19\)](#)

7 MËNYRA SE SI PUNËDHËNËSIT MUND TË MBËSHTESIN PRINDËRIT QË PUNOJNË GJATË PËRHAPJES SË SËMUNDJES SË KORONAVIRUSIT (COVID-19)

Fëmijët në gjithë botën kanë nevojë për përkrahjen e prindërve të tyre tani. Ndërsa prindërit kanë nevojë për mbështetje nga punëdhënësit e tyre.

Pasojat e përhapjes së sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) po ndjehen në të gjithë botën. Për shumë fëmijë, kjo do të thotë të përballesh me arsimin e çrregullt, sëmundjet në familje dhe humbjen e të ardhurave familjare - gjëra që prekin në mënyrë disproporcionale vajzat dhe djemtë nga familjet më të varfra.

Duke u dhënë prindërve që punojnë kohën dhe mbështetjen e nevojshme për kujdesin për fëmijët e tyre, politikat e vendit të punës që janë miqësore për familjen - si pushimi prindëror me pagesë, pushimi mjekësor me pagesë, aranzhimet fleksibile të orarit dhe qasja në kujdes të përbalueshëm e cilësor për fëmijë - ndihmojmë të zbutet barra mbi fëmijët.

Këtu janë shtatë mënyra në të cilat punëdhënësit mund të mbështesin prindërit që punojnë që të kujdesen për veten, fëmijët dhe familjet e tyre gjatë pandemisë së COVID-19:

1. Vlerësoni nëse politikat aktuale të vendit të punës përkrahin efektivisht familjet.

A janë politikat ekzistuese mjaftueshëm mbështetëse për familjet? Filloni duke identifikuar nevojat më të ngutshme të prindërve që punojnë. Fokus specifik duhet të kenë grupet e cenueshme, të tilla si punëtorët e përkohshëm, ata joformalë, emigrantët, shtatzënat apo nënat gjdhënëse, punëtorët me aftësi të kufizuara dhe ata që nuk kanë qasje në beneficione, si pushimi mjekësor me pagesë.

2. Ofroni mundësi fleksibile të punës.

Aranzhimet fleksibile të punës u japin punëtorëve liri për të vendosur se kur dhe ku mund t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre të punës. Pasi që nevojat e prindërve që punojnë mund të dallojnë shumë, ka lloje të ndryshme të aranzhimeve fleksibile të punës në përkrahje të prindërve për t'u kujdesur për fëmijët dhe familjet e tyre. Aranzhimet fleksibile të punës përfshijnë punën nga distanca, ngjeshjen e orarit të javës së punës ose sigurimin e pushimit afatgjatë të mbrojtur, në mënyrë që punëtorët të kujdesen për të afërmit që janë të sëmurë, të moshuar ose jetojnë me aftësi të kufizuara.

3. Mbështetni prindërit me opsione të sigurt, të qasshme dhe të përbalueshme të kujdesit për fëmijë.

Derisa mbyllja e shkollave dhe kopshteve po zgjerohet edhe më shumë, shumë prindër që punojnë përballen me mundësi të kufizuara apo mungesë të kujdesit për fëmijë. Disa madje mund të detyrohen t'i lënë fëmijët e vegjël nën mbikëqyrje të kufizuar, duke komprometuar sigurinë e tyre. Punëdhënësit mund t'i përkrahin këta prindër në mënyra të shumta, edhe përmes sistemeve referuese të kujdesit për fëmijë (në vende ku kujdesi për fëmijë mbetet i disponueshëm dhe i sigurt), përmes subvencioneve dhe aranzhimeve fleksibile të punës.

4. Promovoni higjienën e mirë brenda dhe jashtë vendit të punës.

Për prindërit që bëjnë punë esenciale në punishte, punëdhënësit mund t'i mbrojnë duke i mbajtur vendet e punës të pastra dhe higjienike, si dhe duke siguruar pika të larjes së duarve me ujë të rrjedhshëm dhe sapun, ose dezinfektues duarsh me bazë alkooli aty ku pikat e larjes së duarve nuk janë në dispozicion. Nënata që punojnë duhet të përkrahen që të vazhdojnë gjidhënien në ambiente të pastra dhe të rehatshme për gjidhënie. Punëdhënësit gjithashtu mund të ndihmojnë në mbrojtjen e të gjithë punëtorëve - përfshirë ata që punojnë nga distanca - duke shpërndarë mesazhe kyçe për masat parandaluese, udhëzimet për udhëtime dhe mënyrat për të biseduar me fëmijët e tyre rreth virusit.

5. Ofroni punëtorëve udhëzime se si të kërkojnë shërbime mjekësore.

Punëdhënësit mund të ndihmojnë në orientimin e punëtorëve që mund të përjetojnë simptoma të COVID-19 tek institucionet dhe shërbimet shëndetësore. Për shembull, punëdhënësit mund të komunikojnë qartë adresat dhe numrat e telefonit të spitaleve lokale, institucioneve shëndetësore dhe linjave emergjente. Ata gjithashtu mund t'u japin punëtorëve udhëzime për transport të sigurt deri tek institucionet shëndetësore.

6. Ndhmoni punëtorët dhe familjet e tyre të përballen me stresin.

Vendet e punës duhet të ofrojnë mbështetje të veçantë për punëtorët që ndjejnë ankth, huti apo frikë gjatë shpërthimit të COVID-19. Ato gjithashtu mund të mbështesin prindërit që punojnë që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre të përballen me ankthin dhe frikën. Punëdhënësit duhet të sigurojnë që të shpërndahen vetëm informata nga burime të besueshme si dhe që të gjithë punëtorët të kenë qasje në shërbime psiko-sociale. Ata gjithashtu duhet t'u ofrojnë prindërve që punojnë kohën dhe resurset e nevojshme për t'i qetësuar dhe kujdesur për fëmijët e tyre. Kjo përfshin edhe ofrimin e mjeteve ndihmëse që inkurajojnë bisedën, lojën dhe forma të tjera të stimulimit që fëmijët kanë nevojë nga ana e kujdestarëve.

7. Zvogëloni barrën financiare nëse punëtorët ose anëtarët e familjeve të tyre sëmuren me COVID-19.

Zvogëlimi i barrës së mundshme financiare të shpërthimit të COVID-19 për prindërit që punojnë është gjë thelbësore. Masat mbështetëse mund të përfshijnë mbrojtjen e punësimit, pushimin mjekësor me pagesë, si dhe transferet ekonomike, si beneficionet e fëmijëve dhe subvencionet për shpenzimet shëndetësore. Grupeve të cenueshme, siç janë punëtorët me të ardhura të ulëta dhe atyre joformalë, duhet t'u sigurohet mbështetje e veçantë.

Politika miqësore për familjen për të gjithë

Qenësore është që punëdhënësit të sigurojnë që politikat miqësore për familjen të zbatohen për të gjithë punëtorët, pavarësisht nga gjinia ose statusi i punësimit (pavarësisht nëse janë të punësuar apo me kontratë, për shembull). Promovimi i një kulture në të cilën punëtorët ndjehen rehat me shfrytëzimin e politikave, pa frikë nga diskriminimi apo hakmarrja, është thelbësore. Sidomos për gratë, të cilat në shumë vende marrin përsipër më shumë përgjegjësi të kujdesit sesa burrat, duhen marrë masa për të siguruar që nënata që punojnë të mos ndëshkohen për vendimet e tyre. Me miratimin dhe shtrirjen e politikave miqësore për familjen, punëdhënësit kanë rol qendror në mbështetjen e mirëqenies së prindërve që punojnë dhe fëmijëve të tyre.

REKOMANDIME TË NDËRMJETME, 27 MARS 2020

Ky dokument bazohet në materialin e zhvilluar nga UNICEF EAPRO, UNICEF ESARO dhe ILO. Ky është shënim i përkohshëm udhëzues, hartuar në një situatë që zhvillohet me shpejtësi. Ky ofron rekomandime të përgjithshme që synojnë të ndihmojnë punëdhënësit që të përforcojnë mbështetjen për punëtorët dhe familjet e tyre. Shënimi duhet të adaptohet në nivel lokal dhe kontekstet në ndryshim të shpejtë. Meqenëse informatat e dhëna në këtë dokument mund të vjetrohen shpejt, këshilloheni të kontrolloni rregullisht burimet dhe informacionin në internet (përmes vegëzave).



POLITIKAT MIQËSORE PËR FAMILJEN DHE PRAKTIKAT E TJERA TË MIRA TË VENDEVE TË PUNËS NË KONTEKST TË COVID-19:

Hapat kryesorë që mund të ndërmarrin punëdhënësit

Pasojat e përhapjes së sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) janë të papara dhe po ndjehen në të gjithë botën. Kjo pandemi po rëndon shumë mbi tregjet e punës dhe ekonominë, duke përfshirë zinxhirët globalë të furnizimit, duke çuar në çrregullime të mëdha të bizneseve. Derisa shumë biznese luftojnë për të mbijetuar, humbja e vendeve të punës dhe të ardhurave, si dhe varfëria në rritje e të punësuarve, janë realitet për shumë punëtorë.¹

Të vetëpunësuarit, punëtorët në shtëpi dhe ata që angazhohen në punë kujdesi dhe ata në punë me mëditje apo të përkohshme, janë në rrezik të veçantë.² Mungesa e sistemeve adekuate të mbrojtjes sociale përkeqëson cenueshmërinë ndaj krizës të familjeve të punëtorëve.

Për shumë fëmijë dhe familjet e tyre, kjo situatë që po zhvillohet shpejt nënkupton shkollim e kujdes të çrregulluar për fëmijë, sëmundje në familje dhe humbje të mundshme të të ardhurave shtëpiake.

Kufizimet e lëvizjes së lirë dhe ndikimi socio-ekonomik i krizës i vë fëmijët në rrezik të abuzimit, neglizhencës dhe dhunës.³ Në kontekstin e mbylljes së shkollës dhe kopshteve, përgjegjësitë e kujdesit shtëpiake për prindërit që punojnë, veçanërisht gratë, janë rritur ndjeshëm gjatë krizës.

Duke u dhënë prindërve që punojnë kohën, informatat, shërbimet dhe resurset e nevojshme për të përballuar krizën, politikat dhe praktikat që janë miqësore për familjen mund të jenë dallimi kritik.

Ato po ashtu ofrojnë kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen e gjerë sociale.

Punësimi dhe mbrojtja e të ardhurave, pushimi me pagesë për t'u kujdesur për anëtarët e familjes, rregullimet fleksibile të punës dhe qasja në kujdes cilësor, emergjent të fëmijëve janë masa të rëndësishme që u mundësojnë punëtorëve të mbrojnë dhe të kujdesen për veten e tyre, fëmijët e tyre dhe të afërmit e tyre. Punëdhënësit po ashtu mund të luajnë rol të rëndësishëm në grumbullimin dhe raportimin e të dhënave të kategorizuara në gjini, mbi atë se si kjo situatë po ndikon posaçërisht tek gratë.

Ky dokument ofron rekomandime (të përkohshme) për punëdhënësit në lehtësimin e pasojave negative që rrjedhin nga COVID-19.

1 ONP (ILO) vlerëson se deri në 25 milionë vende pune globalisht janë të rrezikuara për shkak të pandemisë COVID-19. ONP (18 mars 2020), Covid-19 and world of work (Covid-19 dhe bota e punës): Impacts and Responses (Ndikimet dhe reagimet).

2 Shih ILO (20 Mars): Vendet më pak të sigurta të punës të shtyra deri në skaj nga COVID-19.

3 Shih UNICEF (20 Mars): COVID-19: Children at heightened risk of abuse, neglect, exploitation and violence amidst intensifying containment measures (Fëmijët në rrezik të shtuar të abuzimit, neglizhencës, eksploatimit dhe dhunës mes masave izoluese në intensifikim e sipër).

Çështje të përgjithshme	
Monitoroni afërsisht dhe ndiqni këshillat nga autoritetet shtetërore dhe lokale	<ul style="list-style-type: none"> • Monitoroni këshillat e dhëna nga autoritetet shtetërore dhe lokale (p.sh. për masat e shëndetit publik dhe rregullimet e punës), si dhe komunikoni informatat kritike tek fuqia punëtore. • Vlerësoni rreziqet e mundshme të çrregullimit të biznesit dhe shqyrtoni apo hartoni një plan të vazhdimësisë së biznesit, që është në përputhje me udhëzimet e autoriteteve shtetërore dhe lokale. • Kërkoni këshilla dhe mbështetje nga shoqatat e punëdhënësve dhe bizneseve, të cilët mund të orientojnë shqetësimet drejt qeverisë, si dhe të formësojnë masat dhe politikat që mbështesin qëndrueshmërinë e biznesit dhe gjendjen e punëtorëve dhe familjeve të tyre.
Vlerësoni nëse politikat aktuale të vendeve ofrojnë mbështetje të mjaftueshme për punëtorët dhe familjet e tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikoni nevojat më të ngutshme të punëtorëve dhe familjeve të tyre, duke organizuar dialog social domethënës, relevant për kontekstin. Angazhohuni drejtpërdrejt me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre (p.sh. sindikatat), përfshirë në mënyrë virtuale, kurdo që të jetë e nevojshme, për nevojat më emergjente të punëtorëve. • Përqendrohuni posaçërisht tek masat me ndjeshmëri gjinore dhe grupet e cenueshme dhe/ose të marginalizuara. Ndër të tjera, këto grupe mund të përfshijnë punëtorët joformalë, të përkohshëm, të rinj/të moshuar, migrues, punëtore shtatzana ose gjdhënëse, prindër vetushqyes, punonjës shëndetësorë apo të kujdesit dhe ata që nuk gëzojnë të drejta apo beneficione të punësimit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet punonjësve me aftësi të kufizuara ose atyre që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara.
Aplikoni praktikat e mira kur zbatoni politika ekzistuese ose të reja	<ul style="list-style-type: none"> • Siguroni që masat të jenë të hartuara në përputhje me ligjet shtetërore të punës dhe standardet ndërkombëtare të punës, si dhe të bazuara në angazhimin e punëtorëve dhe dialogun social. Standardet ndërkombëtare të punës ofrojnë themele të forta për të lehtësuar pasojat negative për punëtorët dhe familjet e tyre. • Grumbulloni dhe raportoni të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë lidhur me nivelin e infeksionit në zhvillim, ndikimet ekonomike, barrën e kujdesit dhe ndikimin e dhunës seksuale dhe abuzimit; • Sigurohuni që të gjithë punëtorët të gëzojnë masa të përkrahjes në vend të punës, dhe që të gjithë punëtorët të dinë për to, t'i kuptojnë e të ndjehen rehat me shfrytëzimin e tyre. • Aplikoni masa për të gjithë punëtorët (të punësuarit e rregullt dhe jo të rregullt), pa asnjë diskriminim të çfarëdo lloji, me fokus tek më të pafavorizuarit (p.sh. ata që janë më pak të mbrojtur dhe me pagë të ulët). • Siguroni barazi gjinore e diversitet në gjithë procesin e vendimmarrjes, pasi këto i përkasin monitorimit dhe grumbullimit të informatave, si dhe informojnë tutje proceset e hartimit të politikave. • Vlerësoni efikasitetin dhe gjithëpërfshirjen e masave të përkrahjes në vend të punës përmes konsultimit me përfaqësuesit e punëtorëve, edhe në mënyrë virtuale, dhe përshtatuni shpejt sipas nevojës. • Sipas rastit, merrni parasysh pasojat sociale të vendimeve afariste mbi partnerët, përfshirë ata në zinxhirët globalë të furnizimit. Ruajtja e marrëdhënieve afariste dhe vëllimit të porosive, si dhe ndihma për furnizuesit me përkrahje teknike mund të ndihmojnë në zbutjen e pasojave negative sekondare për punëtorët dhe familjet e tyre.
Mbroni vendin e punës nga diskriminimi dhe stigma sociale	<ul style="list-style-type: none"> • Zbatoni masa për parandalimin dhe adresimin e diskriminimit, dhunës dhe ngacmimit në vend të punës (në kontekstin e COVID-19 dhe më gjerë). • Ofroni trajnime për punëtorët për të tkurrur stigmën sociale dhe për të parandaluar diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin ndaj punëtorëve dhe/ose anëtarëve të familjes së tyre lidhur me COVID-19. • Inkurajoni punëtorët të jenë proaktivë në raportimin e incidenteve me sjellje të papërshtatshme, diskriminuese, ngacmuese ose abuzive tek mbikëqyrësit e tyre, departamenti i burimeve njerëzore, sindikata ose menaxhmenti. • Ndërmerrni hapa për të siguruar që mekanizmat e raportimit të jenë konfidencialë, me ndjeshmëri gjinore dhe të sigurt. Inkurajoni shfrytëzimin e gjerë dhe jo-diskriminues të këtyre mekanizmave, si dhe siguroni që ato të jenë lehtësisht të qasshme për të gjithë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara, migruesit dhe grupet e pakicave. • Identifikoni rastet e diskriminimit dhe veproni menjëherë mbi to.

Hapat specifike që mund të ndërmarrin punëdhënësit	
<p>1 Zbatoni aranzhime fleksibile të punës</p>	<p>Nëse dizajnohen mirëfilli, aranzhimet fleksibile të punës u japin punëtorëve liri për të vendosur se kur dhe ku mund të përmbushin përgjegjësitë e tyre të punës. Ato përkrahin punëtorët në plotësimin e nevojave të tyre personale ose familjare dhe të arrijnë baraspeshë më të mirë mes punës e jetës. Ato gjithashtu rrisin produktivitetin e punëtorëve në rrethana sfiduese. Aranzhimet fleksibile të punës janë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e mbylljes së gjerë të shkollave dhe mundësive të kufizuara të kujdesit për fëmijët.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërmerrni një vlerësim organizativ për të parë se çfarë lloj orarësh fleksibile do të plotësonin më së miri nevojat e punëtorëve, përfshirë prindërit dhe ata me përgjegjësi të tjera familjare, si kujdesi për anëtarët e moshuar ose të sëmurë të familjes, në kontekst krize, ndërkohë që sigurohet edhe vazhdimësia e biznesit. • Ofroni aranzhime fleksibile të punës të cilat i përgjigjen nevojave të punëtorëve dhe familjeve të tyre. Rregullimet e tilla mund të jenë, për shembull, puna nga distanca apo shtëpia (shih udhëzimin e ONP-së), fleksi-oraret dhe ngarkesa e zvogëluar e punës (shih tabelën më poshtë). Aranzhimet fleksibile të punës duhet të bazohen në dialog social e konsultime me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre. • Aplikoni fleksibilitetin në orar (si dhe sipas mundësisë, edhe në lokacion) në rastin e punës nga largësia, në mënyrë që prindërit të mund të punojnë në kohën dhe vendin më të përshtatshëm për ta. Pajtohuni mbi detyrat prioritare për t'i përkrahur punëtorët që të jenë sa më produktivë në kontekstin e kujdesit dhe përgjegjësi familjare të shtuara. Sigurohuni që të gjithë eprorët të demonstrojnë fleksibilitet në rastet e punës nga distanca. • Sigurohuni që prindërit që punojnë të kenë kohë të mjaftueshme për të përkrahur mësimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre, si dhe të kalojnë kohë me fëmijët e tyre për të përballuar stresin. Në rast sëmundjeje familjare ose ndarjeje, siguroni pushim me pagesë për të ofruar kujdes dhe për të ruajtur kontaktet me anëtarët e familjes, pa rrezikuar sigurinë e të ardhurave. • Nëse aranzhimet e tilla fleksibile nuk janë të mundura, shqyrtoni mbështetjen alternative për prindërit që punojnë, siç është mbështetja për kujdesin ndaj fëmijëve (shih pjesën për kujdesin e fëmijëve më poshtë).

Shembuj të rregullimeve fleksibile të punës		
FLEKSI-ORARI	FLEKSI-PUSHIMET	FLEKSI-LOKACIONI/ROLI
<ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja dhe shënimi i orëve të punës • Ngjeshja e javës së punës • Orare fleksibile të punës • Ndarje e punës mes pozitive • Ndërrimi i orareve mes punëtorëve 	<ul style="list-style-type: none"> • Pushimi mjekësor me pagesë • Pushim për kujdes emergjent me pagesë • Pushime shitesë ose të zgjatura të festave apo personale • Pushime më të gjata duke ruajtur punësimin • Orare të tkurrura (gjysmë orari) me pagesë të njëjtë për orë • Pushime për gjidhënie, me pagesë 	<ul style="list-style-type: none"> • Punë nga distanca apo në udhëtim • Punë e përkohshme në distancë për qëllime të përkujdesjes • Ndryshime në përgjegjësi

Hapat specifike që mund të ndërmarrin punëdhënësit	
<p style="font-size: 2em; font-weight: bold; color: #0070C0; margin: 0;">2</p> <p>Mbështesni prindërit që punojnë me opsione të kujdesit për fëmijë që janë të sigurta dhe të përshtatshme në kontekstin e COVID-19 bile të punës</p>	<p style="color: #0070C0;">Kujdesi për fëmijë është pjesë përbërëse e politikave miqësore ndaj familjes, në aspektin e ofrimit të stimulimit dhe kujdesit të përgjegjshëm për fëmijët e vegjël derisa ata punojnë. Në kontekstin e mbylljes së përgjithshme të shkollave dhe kopshteve për fëmijë, punëdhënësit mund të ofrojnë mbështetje kritike për prindërit që përballen me opsione të kufizuara ose të munguara për kujdes të fëmijëve. Disa prindër madje mund të detyrohen të lënë fëmijët e vegjël nën mbikëqyrje të kufizuar, duke komprometuar sigurinë e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbani në mend se mbështetja e kujdesit për fëmijët mund të marrë forma të shumta, bazuar në mundësinë e realizimit të tyre si dhe nevojat e punëtorëve. Punëdhënësit idealisht do të duhej të ofronin një sërë masash të përziera që pasqyrojnë nevojat e larmishme të punëtorëve dhe fëmijëve të tyre, duke përfshirë edhe ofrimin e informatave mbi disponueshmërinë e shërbimeve të kujdesit për fëmijët në kontekstin e shpërthimit të COVID-19. • Merrni parasysh masat që mund të jenë edhe si qendra të kujdesit për fëmijët në vendin e punës (sipas rastit e në kontekstin e COVID-19), kujdesi emergjent i fëmijëve, shkollimi për fëmijët e punëtorëve në vijë të parë të reagimit (përfshirë punonjësit shëndetësorë dhe punonjësit tjerë të kujdesit), shtesat për fëmijë, sistemet e referimit për kujdes, si dhe bashkëpunimi me institucione të jashtme të kujdesit për fëmijë në situata emergjente (private ose publike). • Merrni parasysh që disa prindër preferojnë aranzhime të kujdesit që janë më afër shtëpisë, ku ata kanë rrjete të besueshme të mbështetjes dhe/ose kur nuk munden apo nuk preferojnë të udhëtojnë me fëmijën e tyre (p.sh., udhëtime të gjata, kushte të pasigurta, kosto të larta). Në raste të tilla, siguroni mbështetje, për shembull, përmes orareve fleksibile dhe shtesave të kujdesit për fëmijë. • Siguroni përfshirjen e punëtorëve që kanë më së shumti nevojë. Mbështetja e kujdesit për fëmijë duhet të mbulojë sa më shumë familje që punojnë, sidomos fëmijët nga familjet më të cenueshme (p.sh. punëtorët me të ardhura të ulëta, migrantë dhe joformalë, punëtorët në punë shtëpiake dhe të perkujdesjes, personat me aftësi të kufizuara, familjet me një kryefamiljar/e dhe prindërit pa mbështetje nga familja e gjerë). • Sigurohuni që kujdesi i fëmijëve të jetë jo-diskriminues, i bazuar në nevoja, i qasshëm, i përballueshëm, i sigurt dhe me cilësi të lartë (për udhëzime specifike, shih IFC Tackling Care Child: A Guide for Employer-Supported Childcare - IFC: Përballja me kujdesin për fëmijë: Udhëzues për Kujdesin e mbështetur nga punëdhënësi). • Sigurohuni që vendet e punës në sektorin e kujdesit për fëmijë të jenë punë cilësore. Shërbimet cilësore të kujdesit për fëmijë bazohen në numra adekuatë dhe kushte të duhura të punës për punëtorët e kujdesit për fëmijë (për udhëzime specifike, shih ILO Policy Guidelines on the promotion of decent work for early childhood education personnel ONP Udhëzues i politikave për promovimin e vendeve të mira të punës për personelin në edukimin e hershëm).

3

Parandaloni dhe adresoni rreziqet e vendit të punës duke përforcuar masat e sigurisë dhe shëndetit në punë

Mbrojtja e shëndetit të punëtorëve, klientëve, përdoruesve dhe palëve tjera të treta duhet të jetë prioriteti më i lartë i punëdhënësve.

- Përgatitni një plan gatishmërie dhe reagimi për parandalimin e COVID-19, duke marrë parasysh të gjitha punishtet, detyrat që kryhen nga punëtorët si dhe burimet e mundshme të ekspozimit.
- Identifikoni dhe lehtësoni të gjitha rreziqet e ekspozimit të punëtorëve dhe personave të tjerë të lidhur me vendin e punës që rrjedhin nga COVID-19, për sa i përket infektimit nga njeriu në njeri, ose kontaktit me sipërfaqe ose objekte të kontaminuara.
- Hartoni një plan mbi atë që duhet të bëhet nëse konfirmohet apo dyshohet për një rast të COVID-19 në vendin e punës, përfshirë raportimin, njoftimin, monitorimin, riorganizimin e punës dhe dezinfektimin.
- Këshillohuni me punëtorët, përfaqësuesit e punëtorëve dhe komisionet e sigurisë e shëndetit, edhe virtualisht kur ka nevojë, për masat që duhen zbatuar.
- Promovoni higjienën në vend të punës si dhe aplikoni parimet përkatëse për të siguruar distancimin fizik në vendin e punës (shih [udhëzuesin e OBSH-së](#)).
- Siguroni disponueshmërinë e hapësirave për larje të duarve me sapuni dhe mirëmbani e pastroni rregullisht dyqanet, objektet dhe vendet e punës. Hapësirat për larje të duarve duhet të jenë në afërsi me zonat që janë kritike për larjen e duarve (p.sh. tualetet, ambientet e klinikave shëndetësore, hyrjet e ndërtesave, hapësirat e takimeve, byfetë/mensat).
- Siguroni sinjalizime brenda hapësirave të larjes së duarve të cilat paraqesin teknikat e duhura të larjes së duarve dhe oraret kritike për larjen e duarve (shih udhëzuesin e OBSH-së).
- Siguroni edhe disponueshmërinë e dezinfektuesve me bazë alkooli (së paku 60 përqind alkool) dhe inkurajoni fuqimisht përdorimin e tyre kur hapësirat e larjes së duarve nuk janë të disponueshme.
- Sigurohuni që maskat për fytyrë dhe/ose faculetat e letrës të jenë të disponueshme në vendet e punës, për ata që kanë simptoma respiratorike (p.sh. kollë apo teshtitje), së bashku me koshat me kapakë për largimin higjienik të tyre.
- Shpeshtoni pastrimit të hapësirave të përbashkëta dhe sipërfaqeve që preken më shpesh (p.sh. dorezat e dyerve, butonat e ashensorit).
- Siguroni pajisje personale mbrojtëse, sipas nevojës, përkatësisht për raste të dyshuara dhe profesionet me rreziqe të veçanta (psh: menaxhimi i mbeturinave, kujdesi shëndetësor).
- Siguroni masa të veçanta shëndetësore dhe të sigurisë për punonjësit shëndetësorë të vijës së parë - shumë prej të cilëve janë gra (shih kutinë më poshtë).
- Siguroni mbrojtjen e amësisë (përfshirë pikat lidhur me sigurinë dhe shëndetin në punë) për të gjitha gratë çdokund, së paku në pajtim me [Konventën e ONP-së për Mbrojtjen e Amësisë, 2000 \(Nr. 183\)](#) dhe [Rekomandimin përcjellës të saj Nr. 191](#).

	<ul style="list-style-type: none"> • Kudo që është e mundur, siguroni dhoma të pastra për gjidhënie, ku gratë mund të nxjerrin qumështin. Dhomat e tilla duhet të jenë të pajisura me faculeta dezinfektuese, kosh mbeturinash me kapak, dezinfektues duarsh me së paku 60 përqind alkool, si dhe qasje në hapësira për larje duarsh (shih UNICEF COVID-19 What parents should know (Çfarë duhet të dijnë prindërit) dhe OBSH Q&A on pregnancy, child-birth and breastfeeding in the context of COVID-19 - Pyetje e përgjigje për shtatzaninë, lindjen e fëmijut dhe gjidhënien në kontekstin COVID-19). • Mbështetni gratë shtatzëna që të ndërmarrin masa të kujdesit për të mbrojtur veten dhe për të raportuar simptomat e mundshme tek institucioni i tyre shëndetësor. Për shkak të ndryshimeve në trupin dhe sistemin e tyre imunitar, gratë shtatzëna mund të jenë më të cenueshme ndaj infeksioneve respiratorike, përfshirë COVID-19 (shih OBSH Pyetje e përgjigje për shtatzaninë, lindjen e fëmijut dhe gjidhënien në kontekstin COVID-19). • Pastroni hapësirat e kujdesit për fëmijët në vend të punës dhe pajisni ato me ujë të pastër, sapun dhe pastrim të duarve me dezinfektues duarsh me bazë alkooli (së paku 60 përqind alkool).
--	---

Gratë përbëjnë pjesën më të madhe të fuqisë punëtore shëndetësore në të gjithë botën. Si mjekë, infermiere dhe punonjëse shëndetësore në komunitet, ato janë në vijën e parë të reagimit. Sipas OBSH-së, gratë përbëjnë shumicën e punëtorëve në sektorin e shëndetit dhe kujdesit social - 70 përqind në 104 vende të analizuara nga OBSH-ja. Ato gjithashtu fitojnë 11 përqind më pak se burrat në të njëjtin sektor. Shumë prej këtyre grave janë vullnetare dhe gjithashtu duhet të kujdesen për familjet e tyre. Shumë nga to rrezikojnë jetën e tyre pasi u shërbejnë të tjerëve, shpesh pa ndonjë mekanizëm kujdesi ose mbështetjeje. Në përgjigje ndaj krizës COVID-19, autoritetet kineze dërguan më shumë se 41,000 punonjës shëndetësorë nga i gjithë vendi për të mbështetur stafin mjekësor në epiqendrën e shpërthimit në provincën Hubei. Më se gjysma e mjekëve dhe 90 përqind e infermierëve në Hubei ishin gra, sipas Federatës së Grave në Shangai, organ qeveritar.

4

Ofroni udhëzime dhe trajnime për masat e sigurisë dhe shëndetit dhe praktikën e higjienës në punë

Distanca fizike, larja e duarve dhe edukimi për higjienën janë mënyra kritike për të penguar përhapjen e infektimit me COVID-19.

- Shpërndani broshura edukative e ofroni trajnime, kurdo që nevojitet, për punëtorët në mbështetje të masave të sigurisë dhe shëndetit në punë, praktikave higjienike dhe masave të tjera për të mbrojtur veten, familjet dhe komunitetet e tyre. Afishoni posterë në mure me këshilla për parandalimin dhe mbrojtjen. Mesazhet duhet të ndjekin [këshillat e OBSH-së për publikun](#).
- Për mesazhet për mbrojtjen e fëmijëve, shih [UNICEF coronavirus disease \(COVID-19\): What parents should know and how to protect themselves and their children](#) (UNICEF Sëmundja Koronavirus (COVID-19): Çfarë duhet të dinë prindërit dhe si të mbrojnë veten dhe fëmijët e tyre).
- Për nënat gjidhënese që punojnë, inkurajoni dhe mbështetni ato të vazhdojnë gjidhënien. Hapësirat për gjidhënie apo nxjerrje të qumështit duhet të kenë produktet e nevojshme për higjienë adekuate, përfshirë faculetat dezinfektuese, koshin e mbeturinave me kapak, dezinfektuesin e duarve me së paku 60 përqind alkool dhe qasjen në hapësira për larje të duarve.
- Këshilloni nënat me simptoma që gjithsesi të ushqejnë me gji dhe të mbajnë maskë kur ndodhen pranë fëmijës (përfshirë gjatë ushqyerjes) dhe të lajnë duart para dhe pas kontaktit me fëmijën. Mbështetni nënat me simptoma që të kërkojnë kujdes të hershëm mjekësor dhe që të ndjekin udhëzimet nga institucionet shëndetësore ([shih Udhëzuesin e UNICEF-it për prindër](#)).
- Në rastet kur ofrohen shujta ushqimore në vendin e punës, kujdesuni për sigurinë e ushqimit. Kjo përfshin këshillimin e punëtorëve për masat e kujdesit për trajtimin e mishit të gjallë, qumështit apo organeve shtazore për të shmangur kontaminimin e kryqëzuar me ushqime të paziera, sipas praktikave të sigurisë ushqimore dhe [udhëzimeve të OBSH-së](#).

5

Inkurajoni punëtorët të kërkojnë kujdesin e duhur mjekësor në rastet e etheve, kollës dhe vështirësive në frymëmarrje

Në mungesë të vaksinës, zbutja e rrezikut të ekspozimit ndaj virusit COVID-19 është mënyra më e sigurt për të parandaluar infeksionin. Në rastet kur punëtorët zhvillojnë simptoma, inkurajoni ata të kërkojnë kujdes të duhur mjekësor.

- Ofroni punonjësve udhëzime se ku mund të referohen nëse u paraqiten simptoma që janë të afërta me COVID-19 (adresa dhe numri i telefonit të spitaleve lokale, autoritetet shëndetësore, linjat emergjente). Ndhmoni me transport të sigurt për dërgim kudo që të jetë e mundur dhe e nevojshme.
- Referimet duhet të ofrohen edhe për shërbime të tjera, p.sh. linja telefonike për dhunën në familje, këshillime për shëndetin mendor dhe mbështetje psiko-sociale (shih [Inter-Agency Standing Committee briefing note](#) - Shënim njoftues nga Komisioni i Përhershëm Ndërinstitucional).
- Këshilloni punëtorët pa simptoma që kanë histori udhëtimi në zonat e prekura që të ndjekin të njëjtat masa të kujdesit si gjithë të tjerët (p.sh. udhëzime/mbështetje për referim). Sidoqoftë, varësisht nga politikat e autoriteteve lokale shëndetësore, ata mund të vendosen në karantinë - e kështu të kenë nevojë për mbështetje për qasje në ushqim, ujë, akomodim, shërbime telekomunikimi, shërbime mjekësore, të shëndetit mendor dhe mbështetje psiko-sociale, etj. Për më shumë udhëzime, shih [OBSh Çështjet që duhen trajtuar për riatdhesim dhe karantinim të udhëtarëve](#).
- Sigurohuni që punëtorët që shfaqin simptoma gjithashtu të gëzojnë mbështetje psikologjike.

6

Mbështetni punëtorët që ballafaqohen me stresin dhe sigurinë personale gjatë përhapjes së COVID-19

Rreziku potencial i humbjes së punësimit dhe jofleksibiliteti në vend të punës mund të rrisin stresin e prindërve, gjë që ka ndikim në praktikën e kujdesit prindëror dhe marrëdhëniet prind-fëmijë.

- Kontribuoni në reduktimin e stresit duke përsëritur informata të bazuara në dëshmi e nga burime të besueshme (p.sh. OBSH). Informatat e paverifikuara nga postimet në media konvencionale e sociale mund të krijojnë panik ose stres të panevojshëm.
- Ofroni punëtorëve, veçanërisht grave, informata, këshillim dhe qasje në shërbime. Gratë përballen me rreziqe më të mëdha të dhunës në familje dhe të eksploatimit seksual në kohë krize, kur amvisëritë dhe familjet janë edhe më të tendosura.
- Mblidhni informacione që do t'u ndihmojnë punonjësve të stresuar të kuptojnë saktë dhe të përballojnë rreziqet.
- Mbështetni punëtorët që t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre të përballen me stresin gjatë shpërthimit të COVID-19. Jepini prindërve që punojnë kohën dhe resurset e nevojshme për të qetësuar dhe për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Kjo mund të përfshijë edhe ofrimin e mjeteve ndihmëse dhe materialeve që inkurajojnë bisedën, lojën dhe forma të tjera të stimulimit për të cilin kanë nevojë fëmijët.
- Për rekomandime se si të komunikoni me fëmijët, shihni UNICEF: Si të flisni me fëmijën tuaj për sëmundjen koronavirus 2019 (COVID-19).
- Ofroni punëtorëve sugjerime të shëndosha se si të mbajnë një mënyrë jetese të shëndetshme.

Hapat specifike që mund të ndërmarrin punëdhënësit	
<p>7</p> <p>Mbështesni masat qeveritare të mbrojtjes sociale</p>	<p>Mbrojtja sociale ka rol kyç në adresimin e cenueshmërisë së punëtorëve dhe familjeve të tyre ndaj varfërisë, pabarazisë dhe privimit, veçanërisht në kontekstin e COVID-19. Ndërsa mbrojtja sociale është përgjegjësi e qeverisë, politikat miqësore për familjen në vendin e punës mund t'i mbështesin këto përpjekje.</p> <ul style="list-style-type: none"> Identifikoni mënyra për të mbështetur masat qeveritare të mbrojtjes sociale në përputhje me Konventën e ONP-së Nr. 102 për Sigurinë Sociale (Standardet minimale) dhe Rekomandimi 202 i ONP-së për Dyshemetë e Mbrojtjes Sociale. Mbështetja e kompanisë mund të përfshijë, për shembull, subvencione për punëtorët për qasje në sigurime shëndetësore, të papunësisë dhe invaliditetit, si dhe duhet të mbulojë edhe punëtorët në sektorin joformal. Ofroni transfere të parave për punëtorët në formën e beneficioneve për fëmijë dhe pagesa të tjera që përmirësojnë qëndrueshmërinë e familjeve, veçanërisht ato që janë më pak të favorizuara. Në rast të sëmundjes së punëtorit ose në familje, zbutni implikimet e mundshme financiare duke garantuar pushim mjekësor me pagesë, veçanërisht për gratë që shpesh janë kujdestare parësore, duke i mundësuar familjeve të ruajnë jetesën e tyre.

Kjo përmbledhje është hartuar nga UNICEF dhe ONP, me kontribute nga UN Women. ONP dhe UN Women duan të shprehin mirënjohje për mbështetjen e Instrumentit të Partneritetit të Bashkimit Evropian përmes programit [WE EMPOWER](#).



BURIME TË DOBISHME NË INTERNET

Burimet e OBSH-së për koronavirusin:
www.who.int/health-topics/coronavirus

Sëmundja e koronavirusit, CDC 2019:
www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/about/index.html

OBSH - Si të përgatitni vendin tuaj të punës:
<https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/getting-workplace-ready-for-covid-19.pdf?sfvrsn>

UNICEF - Sëmundja koronavirus (COVID-19) - çfarë duhet të dinë prindërit:
<https://www.unicef.org/stories/novel-coronavirus-outbreak-what-parents-should-know>

Si të flisni me fëmijën tuaj për sëmundjen koronavirus 2019 (COVID-19):
<https://www.unicef.org/coronavirus/how-talk-your-child-about-coronavirus-covid-19>

OBSH: Pyetje e përgjigje për COVID-19, shtatzëninë, lindjen dhe gjdhënie:
<https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/question-and-answers-hub/q-a-detail/coronavirus-disease-covid-19-pregnancy-and-childbirth>

Mbrojtja e fëmijëve gjatë pandemisë së koronavirusit:
[www.unicef.org/media/65991/file/Technical%20note:%20Protection%20of%20children%20during%20the%20coronavirus%20disease%202019%20\(COVID-19\)%20pandemic.pdf](http://www.unicef.org/media/65991/file/Technical%20note:%20Protection%20of%20children%20during%20the%20coronavirus%20disease%202019%20(COVID-19)%20pandemic.pdf)

ILO: COVID-19 dhe bota e punës - ndikimet dhe reagimet:
https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---dcomm/documents/briefingnote/wcms_738753.pdf

UN Women: Gjinia në kuadër të reagimit ndaj COVID-19
<https://www.unwomen.org/en/news/in-focus/in-focus-gender-equality-in-covid-19-response>

Pesë gjëra që duhet të dini për punën efektive nga largësia gjatë krizës së COVID-19:
https://www.ilo.org/global/about-the-ilo/multimedia/video/institutional-videos/WCMS_738575/lang--en/index.htm

Çështje të shëndetit mendor dhe mbështetjes psikologjike në kontekstin e COVID-19:
www.unicef.org/media/65916/file/Briefing_note_on_addressing_mental_health_and_psychosocial_aspects_of_COVID-19_outbreak.pdf

OBSH: Këshilla për sëmundjen e koronavirusit (COVID-19) për publikun - Thyerja e miteve:
<https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/advice-for-public/myth-busters>

Këshilla për punonjësit shëndetësorë:
https://www.who.int/docs/default-source/coronaviruse/who-rights-roles-respon-hw-covid-19.pdf?sfvrsn=bcabd401_0

ILO: Puna në kujdes dhe vendet e punës së kujdesit për të ardhmen e punës së ndershme:
www.ilo.org/global/about-the-ilo/newsroom/news/WCMS_633115/lang--en/index.htm

COVID-19 DHE BARAZIA GJINORE THIRRJE PËR VEPRIM NGA SEKTORI PRIVAT

Gjendja

Pandemia e COVID-19 po vë një barrë të paparë e madhore në ekonominë globale dhe sistemet e shëndetit publik. Po ashtu, ajo po thekson e zgjeron pabarazitë dhe format e shumëfishta dhe të ndërthurura të diskriminimit me të cilin përballen gratë dhe vajzat. Pandemia po shkon edhe përtej një krize globale shëndetësore, duke u transformuar në krizë të tregut të punës, krizë sociale dhe ekonomike, duke paraqitur një kërcënim serioz për punësimin dhe jetesën e grave, veçanërisht në sektorë më pak të sigurt, joformalë e jo-esencialë.

Shumë ndërmarrje janë ngritur në përballje të kësaj sfide dhe po përdorin resurset e tyre për të siguruar informata, furnizime, pajisje e personel në luftën kundër COVID-19. Ato gjithashtu kanë ofruar aranzhime fleksibile në punë, kanë paguar pushime mjekësore, kanë siguruar mbrojtje të të ardhurave dhe kanë ofruar kujdes emergjent të fëmijëve për punëtorët e vijës së parë.¹ Disa drejtorë ekzekutivë dhe udhëheqës kanë pranuar edhe ulje të pagave ashtu që punonjësit e tyre të kishin të ardhura gjatë këtyre kohëve të paqarta. Këto politika jo vetëm që u shërbejnë punonjësve të tyre, por ndihmojnë në zvogëlimin e përhapjes së COVID-19, si dhe në mbrojtje të sistemit publik shëndetësor. Në të njëjtën kohë, disa kompani, sidomos në sektorë jo-esencialë si turizmi dhe hotelieria, kanë vështirësi të qëndrojnë në këmbë, ndërsa njerëzit janë larguar nga puna dhe u janë shkurtuar pagat. Në Bashkimin Evropian, rreth 25% e grave të punësuar janë në vende të pasigurta pune.² Në Shtetet e Bashkuara, papunësia vlerësohet në 13% më 3 Prill 2020, një rritje prej 8.5 milionë njerëz krahasuar me mesin e marsit.³ Miliona familje nuk janë në gjendje të blejnë produkte themelore apo të paguajn faturat e qirave dhe shërbimeve publike.

Pandemia e COVID-19 kërkon një reagim të menjëhershëm, të koordinuar, me fokus tek njerëzit, si dhe me ndjeshmëri gjinore. Qeveritë, bizneset, përfaqësuesit e punëtorëve dhe individët duhet të angazhohen së bashku për të zbutur ndikimin në jetën e njerëzve dhe për t'u ballafaquar me rreziqet specifike dhe cenueshmërinë me të cilat përballen vajzat dhe gratë, për shkak të pabarazive dhe stereotipeve të rrënjësura thellë në shoqëri.

Sektori privat ka përgjegjësi të përdorë fuqinë, ndikimin dhe resurset e tij për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien fizike dhe mendore të punonjësve gjatë kësaj kohe, si dhe të sigurojë që përpjekjet afatgjata të rimëkëmbjes së biznesit të rivendosin stabilitetin ekonomik. Bizneset gjithashtu luajnë rol kyç në adresimin e nevojave të grave, në zinxhirët e furnizimit dhe bazën e klientëve të tyre.

“Pandemia COVID-19 nuk është vetëm çështje shëndetësore. Kjo është tronditje e thellë për shoqëritë dhe ekonomitë tona, ndërsa gratë janë në thelb të përpjekjeve për kujdes dhe reagim që po bëhen. Si reaguese të vijës së parë, profesioniste shëndetësore, vullnetare nga komuniteti, menaxhere të transportit e logjistikës, shkencëtare e të tjera, gratë po ofrojnë kontribute që

1 Shih gjithashtu www.unwomen.org dhe <https://datax.org/resource-center/gender-and-da-ta-resources-related-to-covid-19/>

2 European Institute for Gender Equality (EIGE), “Coronavirus puts women in the front-line,” 25 March 2020. Mund të gjendet në: <https://eige.europa.eu/news/coronavirus-puts-wom-en-frontline>

3 Coronavirus Live Updates: Unemployment Soars as Congress Considers More Relief, The New York Times, April 2020, <https://www.nytimes.com/2020/04/09/us/coronavirus-updates-usa.html>

janë kritike në përballje me pandeminë çdo ditë”⁴

Si punëdhënës dhe motor i rritjes ekonomike, sektori privat ka një rol veçanërisht të rëndësishëm jo vetëm në zbutjen e ndikimit të COVID-19, por edhe në ngadalësimin e përhapjes së virusit. Veprimi i hershëm dhe i shënjestruar nga sektori privat do të zvogëlojë rreziqet e drejtpërdrejta shëndetësore ndaj punonjësve, duke ulur kështu edhe ndikimin e përgjithshëm ekonomik.

COVID-19 do të ketë efekte afatshkurtra dhe afatgjata në ekonominë globale.⁵ Humbjet e vendeve të punës që po i shohim sot do të ndjehen për muaj e vite që do vijjnë në gjithë zinxhirët globalë të furnizimit, duke përfshirë edhe vendet që aktualisht nuk ndodhen në epiqendrën e pandemisë.

E keni ditur se?

COVID-19 po ndikon tek gratë në shumë mënyra, që nga brengat për shëndetin, sigurinë dhe të ardhurat e tyre, deri tek përgjegjësitë shtesë të kujdesit dhe ekspozimi i shtuar ndaj dhunës në familje.

- Ndikime të rritura ekonomike ndjehen posaçërisht nga gratë dhe vajzat që zakonisht fitojnë më pak, kursejnë më pak, si dhe kanë vende pune më pak të sigurta ose jetojnë afër kufirit të varfërisë.⁶
- Sistemet globale të vlerave po tranden nga COVID-19. Gratë kanë role kyçe në secilin nivel, si fermere, punëtoresh, përpunuese, sipërmarrëse, blerëse, ofruese shërbimesh dhe punëmarrëse.
- Gratë janë në vijën e parë si punonjëse shëndetësore, duke punuar me orare të zgjatura e duke u ekspozuar ndaj rreziqeve, ndërsa kujdesen për pacientët. Megjithatë, puna e tyre është shpesh më e nënvlerësuar dhe më pak e paguar.
- Derisa raportet e hershme zbulojnë se më shumë burra po vdesin si rezultat i COVID-19, shëndeti i grave në përgjithësi ndikohet negativisht përmes riallokimit të resurseve dhe prioritetëve, duke përfshirë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues.⁷
- Mbyllja e shkollave dhe kopshteve ka vënë barrë të madhe shtesë mbi gratë brenda shtëpisë. Kjo gjë vë në spikamë mbështetjen e shoqërisë tek gratë dhe vajzat në strukturat formale dhe joformale të kujdesit.
- Ndikimi në bizneset jo-esenciale, sidomos në sektorin e shërbimeve, është veçanërisht shqetësues për gratë si pronare biznesi dhe si të punësuarat. Shumë prej tyre po humbasin jetesën e tyre, sepse puna nga shtëpia nuk është një mundësi.

Në nivel global, gratë përfaqësojnë 55.8% të punëtorëve në industrinë e shërbimeve, ndërsa në G7, gratë përbëjnë rreth 88% të fuqisë punëtore të industrisë së shërbimit. Shumica nuk janë në gjendje të punojnë në distancë dhe mund të kenë nevojë për përkrahje shtesë për fëmijë ose anëtarët e moshuar të familjes, sepse iu duhet të dalin nga shtëpia për të punuar.⁸

- Ndërsa pandemia COVID-19 po thëllon vështirësitë ekonomike dhe shoqërore, bashkë me kufizimin e lëvizjes dhe masat e izolimit social, dhuna në bazë gjinore po rritet në mënyrë

4 UN Women, In Focus: Gender equality matters in COVID-19 response, 2020, <https://www.unwomen.org/en/news/in-focus/in-focus-gender-equality-in-covid-19-response>

5 United Nations Secretary-General Policy Brief, “The Impact of Covid-19 On Women and Girls,” 9 April 2020. Mund të gjendet në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women-en.pdf?la=en&vs=5029>

6 United Nations Secretary-General Policy Brief, “The Impact of Covid-19 On Women and Girls,” 9 April 2020. Mund të gjendet në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women-en.pdf?la=en&vs=5029>

7 OECD, Small Businesses, Job Creation and Growth, <https://www.oecd.org/cfe/smes/2090740.pdf>

8 United Nations Secretary-General Policy Brief, “The Impact of Covid-19 On Women and Girls,” 9 April 2020. Mund të gjendet në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women-en.pdf?la=en&vs=5029>

eksponenciale.⁹

- Izolimi dhe distancimi social kanë rritur rrezikun e dhunës në familje dhe keqtrajttimeve. Gratë në marrëdhënie të dhunshme jo vetëm që i ekspozohen keqtrajtuesve të tyre për periudha të gjata kohore, por edhe nuk janë në gjendje të largohen nga shtëpia ose të thërrasin fshehtas linjat e ndihmës.¹⁰
- Gratë priren të mbështeten shumë më tepër tek transporti publik sesa burrat, gjë që i vë gratë në rrezik më të madh për t'u infektuar me COVID-19 kur janë në lëvizje drejt punës, kujdesit për të afërmit apo për të blerë gjëra në dyqan.
- Distancimi social nuk është i mundur për të gjithë. Miliona familje varen nga kujdesi i përditshëm dhe ndihma nga gratë si kujdestare parësore.

Thirrje për veprim

Parimet e Fuqizimit të Gruas (PFG) janë një grup prej shtatë parimeve që ofrojnë udhëzime për biznese, për të promovuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendin e punës, tregje dhe komunitet. Gjatë kësaj kohe trazirash e pasigurish, parimet PFG janë një burim i shkëlqyeshëm për sektorin privat, për t'i ndihmuar të mbrojnë grupet më të cenueshme. Parimet PFG bazohen tek standardet ndërkombëtare të të drejtave të punës dhe të njeriut, dhe ngrihen mbi mirëkuptimin që bizneset kanë rol, por edhe përgjegjësi, për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Përveç respektimit të politikave dhe urdhrave lokalë e shtetërorë të lidhur me COVID-in, kompanitë duhet të marrin parasysh edhe tre prioritetet e ndërthurura të shtruara nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, António Guterres:¹¹

1. Të sigurohet përfaqësimi i barabartë i grave në gjithë planifikimin dhe vendim-marrjen për reagimin ndaj COVID-19;
2. Të shtyhen përpara ndryshimet transformuese për barazi, duke trajtuar çështjet e kujdesit me dhe pa pagesë;
3. Të shënjestrohen gratë dhe vajzat në të gjitha përpjekjet për të adresuar ndikimin socio-ekonomik të COVID-19.

Këto prioritete të kryqëzuara duhet të jenë pjesë e çdo reagimi ndaj COVID-19, përfshirë ato që bëhen në kuadër të parimeve PFG, si dhe duhen përqendruar rreth punonjësve, grave sipërmarrëse në zinxhirët globalë të furnizimit, konsumatorëve por edhe grave dhe vajzave në komunitete lokale. Këto mëtojnë të sigurojnë që askush të mos mbetet prapa, as gjatë e as pas krizës me COVID-19:

Udhëheqja

- Të sigurohet që politikat specifike për COVID-19 dhe reagimi ndaj krizës të jenë me ndjeshmëri gjinore dhe gjithpërfshirëse, duke konsultuar palët e brendshme dhe të jashtme të interesit;
- Të konsultohen e të ketë bashkëpunim ndërmjet qeverive, punëtorëve dhe punëdhënësve, si dhe përfaqësuesve të tyre, është qenësore që reagimi të jetë efektiv dhe i qëndrueshëm. Gratë duhet të kenë mundësi të marrin pjesë;
- Të shpallet publikisht përkushtimi i Kryeshefit Ekzekutiv dhe ekipit ekzekutiv për të adresuar pabarazitë gjinore, e posaçërisht gjatë pandemisë COVID-19;

9 Women Are Using Code Words at Pharmacies to Escape Domestic Violence During Coronavirus Lockdown, News 7 Boston, 6 April, 2020, <https://whdh.com/news/wom-en-are-using-code-words-at-pharmacies-to-escape-domestic-violence-during-corona-virus-lockdown/>

10 Shikoni shembullin, UNICEF, ILO and UN Women. 2020. "Family-friendly policies and other good workplace practices in the context of COVID-19." Mund të gjendet në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/03/family-friendly-policies-and-oth%ADer-good-workplace-practices-in-the-context-of-covid-19>

11 United Nations Secretary-General Policy Brief, "The Impact of Covid-19 On Women and Girls," 9 April 2020. Mund të gjendet në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women-en.pdf?la=en&vs=5029>

- Të sigurohet diversiteti, si dhe që zërat e grave të kenë një rol në ekipet vepruese dhe ekipet e reagimit të krizës, si dhe që gratë dhe burrat të jenë të përfaqësuar dhe të përfshirë në vendime;
- Të vendosen kanale të qarta komunikimi të brendshëm me punonjësit, me njoftime e këshilla të rregullta dhe të sakta në lidhje me situatën COVID-19;
- Të përkrahohet puna në distancë në përgjithësi, si dhe të lehtësohet barra mbi teknologjinë ekzistuese informative dhe infrastrukturën ekzistuese të komunikimit;
- Të përhapet fjala lidhur me ndikimet e pandemisë që janë të ndryshme për gjini të ndryshme, si dhe të inkurajohen kompanitë tjera të nënshkruajnë parimet PFG.

Vendi i punës

- Të ketë vëmendje ndaj punonjësve me përgjegjësi kujdesi dhe të akomodohen nevojat plotësuese që ata mund të kenë gjatë kësaj kohe krize. Këtu përfshihen orare fleksibile pune për prindërit, sidomos prindërit vetushqyes dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Të miratohen rregullime të orarit fleksibil me pagë të plotë gjatë krizës COVID-19 për të gjithë punëtorët. Të paguhet së paku paga për jetesë për punëtorët me mëditje dhe të kontraktuar, si dhe të ofrohen pushime mjekësore, të familjes dhe të emergjencave;
- Të inkurajohen punonjësit meshkuj që të ndajnë barrën e punëve të shtëpisë dhe kujdesit të papaguar për fëmijë, të moshuar dhe për anëtarë me aftësi të kufizuara të familjes;
- Të merret parasysh shëndeti fizik, mendor dhe emocional i të gjithë punonjësve, si dhe të ketë vëmendje për ekspozimin e shtuar të grave ndaj dhunës në familje gjatë kufizimit në shtëpi. Të shqyrtohet vendosja e një personi të veçantë kontaktues brenda resurseve njerëzore për të përkrahur punëtorët që përballen me dhunën në familje;
- Të ndahen gjerësisht, me të gjithë të punësuarit, informatat për shërbimet publike, duke përfshirë linjat telefonike të dhunës në familje dhe shërbimet mbështetëse për të mbijetuarit e dhunës, shërbimet e ndihmës psikosociale dhe kujdesit shëndetësor para dhe pas lindjes.

Tregu

- Të shfrytëzohet mundësia për të zbuluar biznese të reja lokale, sidomos biznese në pronësi të grave, të cilët preken nga kriza ose ato që ndihmojnë në reagimin ndaj pandemisë. Të blihen produktet dhe shërbimet e tyre dhe të inkurajoni partnerët afaristë dhe punonjësit tuaj të bëjnë të njëjtën gjë;
- Të ofrohen masa përkrahëse për gratë sipërmarrëse që u është dashur të mbyllin biznesin e tyre për shkak të COVID-19 e që mund të kenë vështirësi të paguajnë borxhet. Të ofrohen produkte e shërbime financiare të shënjestruara për t'i shpëtuar ato nga falimentimi;
- Të merren masa proaktive përmes komunikimeve të brendshme dhe të jashtme për të sfiduar stereotipet dhe rolet gjinore, diskriminimin, pabarazinë dhe maskulinitetin e dëmshëm.








Komuniteti

- Të promovohet ndërgjegjësimi dhe vizibiliteti i organizatave të vogla të pavarura dhe grave ose burrave individualë që janë në vijën e parë të përpjekjeve për reagim ndaj pandemisë;
- Të ofrohen grante për organizata dhe institucione si shoqatat e grave dhe strehimoret që përkrahin gratë me nevoja specifike: të moshuarit, të mbijetuarit e dhunës, nënat vetushqyese dhe gratë me aftësi të kufizuara;
- Të dhurohen pajisje mbrojtëse personale, ushqim dhe shërbime për të përkrahur jetën e përditshme të individëve në komunitet, si dhe të ofrohet një moratorium afatshkurtër për shpenzimet shtëpiake, si qiraja dhe shërbimet komunale.

Transparenca dhe raportimi

- Të grumbullohen dhe të raportohen të dhëna të kategorizuara për gjinitë lidhur me shkallët e infeksionit në zhvillim, ndikimet ekonomike, barrën e kujdesit dhe ndikimin e dhunës seksuale dhe abuzimit¹²;
- Të ndahen informata në lidhje me reagimin e ndarë në aspektin gjinor ndaj COVID-19, si pjesë e përkushtimit ndaj parimeve PFG.

12 Shikoni shembullin, UNICEF, ILO and UN Women. 2020. "Family-friendly policies and other good workplace practices in the context of COVID-19." Mund të gjendet në: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/03/family-friendly-policies-and-other-good-workplace-practices-in-the-context-of-covid-19>

Principle 1		Establish high-level corporate leadership for gender equality.
Principle 2		Treat all women and men fairly at work - respect and support human rights and nondiscrimination.
Principle 3		Ensure the health, safety and well-being of all women and men workers.
Principle 4		Promote education, training and professional development for women.
Principle 5		Implement enterprise development, supply chain and marketing practices that empower women.
Principle 6		Promote equality through community initiatives and advocacy.
Principle 7		Measure and publicly report on progress to achieve gender equality

 weps.org  @WEPrinciples
 weps@unwomen.org  @Empower_Women

Funded by:



Produced by:



In support of

**WOMEN'S
EMPOWERMENT
PRINCIPLES**

Established by UN Women and the UN Global Compact Office



DISCLAIMER: The views expressed in this publication are those of the authors and do not necessarily represent the views of the European Union, UN Women, International Labour Organization or the United Nations

